



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	27.05.2022
PËR/ZA/TO:	Drejtorët e drejtorive komunale
PËRMES:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Abit Abiti, ZKF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkore e brendshme Nr.1



Bazuar ne Nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve me dt.13.05.2022 ka lëshuar Qarkoren Buxhetore 2023/01, në këtë qarkore janë paraqitur kufijtë fillestar për secilën Organizatë Buxhetore si dhe afatet kohore. Qarkorja e pare buxhetore është e bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 dhe merr parasysh prioritetet e caktuara me dokumentet strategjike, stabilitetin makro fiskal si dhe përgjigjeje ndaj situatave të krijuara nga COVID19, kriza energjetike dhe inflacioni Gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024 dhe 2025 duhet të përfshihen këto aspekte:

- Fillimisht duhet të caktohen prioritetet e organizatës buxhetore.
- Projektet të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve dhe objektivave të Qeverisë
- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën programeve në përputhje me planin kontabël
- Prioritet t'u jepet projekteve në vazhdimësi dhe projekteve për të cilat kemi kontrata.
- Për projektet kapitale të cilat ka mundësi të kryhen brenda vitit të mos planifikohen si projekte shumëvjeçare
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar për projekte kapitale
- Projektet e reja duhet të caktohen në përputhje me **Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale** si dhe **Udhëzimin Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale** që është aprovuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe ka hyrë në fuqi nga muaji janar i vitit 2020.

Departamenti i buxhetit në MFPT organizon forume me autoritetet e komunave lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor si dhe konsultime për përcaktimin e strukturës sipas kategorive ekonomike, prandaj duhet që paraprakisht t'i identifikojmë kërkesat për kategori ekonomike.

Kërkesat për shpenzime rrjedhëse duhet të jenë brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me Qarkoren buxhetore 2023/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Pagat.- Në parim numri i të punësuarve do të mbetet i njëjtë me numrin e të punësuarve gjatë vitit 2022 Me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 kategoria e Pagave pritet të ketë një rritje 2.6%.

Mallrat dhe shërbimet duhet të buxhetohen mbi bazën e performancës, duke i identifikuar shpenzimet për aktivitete të cilat janë në përputhje me prioritetet e Komunës, parashikimet me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve janë që kategoria e mallrave dhe shërbimeve pritet t'a mbajë nivelin e njëjtë, mirëpo vlerësojmë se për shkak të inflacionit duhet të kemi rritje për 5%.

Kategoria e subvencioneve me KASH parashihet të ketë ulje, mirëpo me qëllim të adresimit të rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit, në programin Infrastrukturë publike, planifikojmë që shpenzimet e varrimit t'i akomodojmë në kategorinë e Subvencioneve.

Projektet Kapitale përfshijnë një pjesë të konsiderueshme në përqindjen e shpenzimeve të tërësishme, për periudhën afatmesme kjo kategori pritet të ketë rritje, këto shpenzime duhet të jenë në përputhje me udhëzimet administrative të cekura më lartë.

Para hartimit të projekt buxhetit hapësirë të veçantë duhet t'u japim dëgjimeve buxhetore me palët me interes të cilat do të organizohen në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa

Planifikimi i Investimeve kapitale bëhet përmes Programit për investime publike (PIP), shënimet në këtë program në sistem i fusin zyrtarët e caktuar, mirëpo duhet tu ofrohen shënime konkrete për projektin nga zyrtarët e programeve në kuadër të të cilit zhvillohet projekti.

Granti i përgjithshëm.-Shuma e grantit të përgjithshëm është e përcaktuar me Nenin 24 të LFPL, krahasuar me vitin 2021 shuma e grantit të përgjithshëm është më e lartë për 32%.

Granti specifik për arsimin parauniversitar sipasë LFPL merre parasysh kriteret e përcaktuara me formulën e MASHT-it, shuma e grantit është e përcaktuar në bazë të disa kriterëve, mirëpo kriteri kryesor është numri i nxënësve të regjistruar në vitin 2021/2022. Shuma e këtij granti krahasuar me vitin 2021 është më e ulët për 1.18%

Shuma e grantit specifik për shëndetësi është për 16% më i lartë se granti gjatë vitit 2022

Komune e Vushtrisë menaxhon me **Shërbimet rezidenciale**, për këtë qëllim janë ndarë 183,000.00€

Kufijtë buxhetor.

Gjatë planifikimit të planifikimit të buxhetit duhet të respektohen kufijtë buxhetor. Komisioni i granteve për Komunën e Vushtrisë sipas LFPL-së i ka ndarë shumat të cilat janë të paraqitura në Qarkoren Buxhetore 2023/01, kurse ne i kemi përmbledhur në tabelën më poshtë.

Tabela

	2022	2023	2024	2025	Ndryshimi 2021/2022	%
Granti i përgjithshëm	7,115,388.00	9,403,786.00	10,085,334.00	10,752,041.00	2,288,398.00	32.16
Granti i arsimit	7,882,034.00	7,788,926.00	8,385,771.00	8,421,899.00	(93,108.00)	(1.18)
Granti për shëndetësi	2,425,419.00	3,097,639.00	3,252,521.00	3,415,147.00	672,220.00	27.72
Shërbimet Rezidenciale	177,250.00	183,000.00	185,000.00	185,000.00	5,750.00	3.24
Gjitsejt grantet	17,600,091.00	20,473,351.00	21,908,626.00	22,774,087.00	2,873,260.00	16.33
të hyrat vetanake	2,262,795.00	2,900,559.00	3,019,774.00	3,148,822.00	637,764.00	28.18
Totali	19,862,886.00	23,373,910.00	24,928,400.00	25,922,909.00	3,511,024.00	17.68

Buxheti planifikohet sipas kategorive ekonomike për programe. Në tabelen më poshtë kemi dhënë një propozim i cili është bazë për Kornizën Afatmesme Buxhetore e cila duhet të miratohet në Kuvendin Komunal deri më 30 Qershor.

	2023					
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunalë	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	211,957	78,974		40,000		330,931
Zyra e Kuvendit komunal	139,058	5,750				144,808
Administrata dhe personeli	207,960	196,098			357,000	761,058
Inspektimi	109,694	28,554				138,248
Prokurimi	50,138	4,465				54,603
Buxheti dhe financa	176,612	31,098				207,710
Infrastruktura publike	83,129	1,007,385	258,500	100,000	2,500,000	3,949,014
Zjarrifikimi dhe inspektimi	220,867	55,125			50,000	325,992
Menshimi i katastrofave	29,785	50,935				80,720
Zyra komunale për komunitet	51,167	8,820	16,500	5,000		81,487
Driftuesi, pyllëri dhe zhytje në ujë	101,738	42,997		200,000	1,000,000	1,344,735
Kadastri dhe gjedezia	94,388	6,063				100,451
Planifikimi urban dhe mjedisi	65,838	47,683			1,115,474	1,228,995
Shëndetësi	1,960,601	647,246	63,000	272,540	712,018	3,655,405
Administrimi	37,812	2,894		207,540		248,246
Shërbimet e shëndetësive primare	1,750,356	530,765	49,500	55,000	712,018	3,097,639
Shërbimet sociale	82,433	38,587	5,500			126,520
Shërbimet rezidenciale	90,000	75,000	8,000	10,000		183,000
Kultura, tani dhe sporti	205,934	49,171		90,000	350,000	695,105
Arsim dhe shkencë	7,288,181	1,345,556	132,000	60,000	1,448,911	10,274,648
Administrimi	93,151	762,297	132,000	60,000	472,011	1,519,459
Arsimi para-shkollor	226,751	74,970			-	301,721
Arsimi i ulët	5,304,620	354,320			755,900	6,414,840
Arsimi i lartë	1,663,659	153,969			221,000	2,038,628
Total	10,997,047	3,605,920	470,000	767,540	7,533,403	23,373,910

Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2023 dhe parashikimet 2024-2025

Planifikimi i të hyrave vetanake është e bazuar në vlerësimet makro fiskale nga departamenti për politika fiskale. Për vitin 2023 me qarkore buxhetore, kufiri i planifikimit për të hyra vetanake është 2,900,559.00€. Kjo shumë krahas granteve i shtohet financimit të Komunal.

	Komuna: Vushtri	THV - 2023	THV - 2024	THV - 2025
1	Buxhet dhe Financa	1,167,144.00	1,198,939.00	1,236,195.00
1.1.	Taksat e firmave	15,000.00	15,000.00	15,000.00
1.2.	Tatimi në pronë	860,432.00	877,641.00	899,582.00
1.3	Tatimi në toka	291,712.00	306,298.00	321,613.00
2	Ispektimet	16,000.00	19,000.00	19,000.00
2.1	Pranime teknike	5,000.00	6,000.00	6,000.00
2.2	Pëlqime sanitare	6,000.00	8,000.00	8,000.00
2.3	Gjobat e inspektionit	5,000.00	5,000.00	5,000.00
3	Administrata	100,000.00	100,000.00	100,000.00
3.1.	Shërbimet administrative	100,000.00	100,000.00	100,000.00
4	Urbanizmi	493,915.00	533,835.00	575,000.00
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	423,915.00	418,835.00	460,000.00
4.2	Leje mjedisore	50,000.00	50,000.00	50,000.00
4.3	Legalizim	15,000.00	15,000.00	15,000.00
4.4	Shfrytëzimi i pronës publike	5,000.00	50,000.00	50,000.00
5	Gjeodezi dhe kadastër	93,000.00	100,000.00	103,000.00
5.1.	Hipoteka, RDDP, dalje në terren	70,000.00	72,000.00	73,000.00
5.2.	Qiraja e pronave publike	23,000.00	28,000.00	30,000.00
6	Ekonomi dhe bujqësi	15,000.00	15,000.00	15,000.00
6.1	Ndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore	15,000.00	15,000.00	15,000.00
7	Kulturë, rini, sport	2,500.00	2,000.00	2,000.00
7.1.	Palestra sportive	1,000.00	1,000.00	1,000.00
7.2.	Bibliotekat	500.00	500	500
7.3.	Shtëpia e kulturës	1,000.00	500	500
8	Shërbimet publike	872,000.00	910,000.00	956,627.00
8.1	Ndalja e veturave në rrugë	2,000.00	3,000.00	4,000.00
8.2	Taksat rrugore	120,000.00	122,000.00	123,000.00
8.3	Taksa për mbeturina	750,000.00	785,000.00	829,627.00
I	Totali i Administratës komunale	2,759,559.00	2,878,774.00	3,006,822.00
	ARSIMI			
1	Çerdhet	60,000.00	62,000.00	63,000.00
2	Mësimi joformal SHMP "Bahri Haxha"	15,000.00	14,000.00	14,000.00
3	Mësimi joformal SHMT "Lutfi Musiqi"	14,000.00	13,000.00	13,000.00
II	Totali - Arsimi	89,000.00	89,000.00	90,000.00
	TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA			
1	Shëndetësia primare	50,000.00	50,000.00	50,000.00
2	Shërbimet sociale	2,000.00	2,000.00	2,000.00
III	TOTALI SHËNDETËSI	52,000.00	52,000.00	52,000.00
Kodi 21	TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I+II+III)	2,900,559.00	3,019,774.00	3,148,822.00

Kalendari kohor.

- Deri më 30 Qershor: aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale
- Deri më 30 Shtator aprovimi i propozim Buxhetit Komunal dhe dërgimi i tabelave 4.1, 4.2 dhe 4.3 në MFPT.

Gjatë kësaj kohe e deri te miratimi i propozim buxhet nga Kuvendi Komunal duhet të zhvillohen konsultime buxhetore me palët me interes.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator

Me qëllim të respektimit të barazisë gjinore së bashku me tabelat e cekura më lart duhet të plotësohen edhe tabelat për Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator dhe atë tabela:

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2023 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Siç e cekëm më lartë deri më 30 Qershor duhet ta miratojmë Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale, në këtë dokument strategjik duhet të merret parasysh :

- Vizionin e Komunës
- Prioritetet afatmesme
- Struktura e veprimtarive ekonomike bazuar në të dhënat e marra nga ARBK
- Tabela e planifikimi i të hyrave vetanake
- Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët
- Planifikimi i buxhetit në kuadër të programeve dhe nënprogrameve
- Planifikimi i buxhetit për kategori ekonomike.

